

FTESE PËR PROPOZIME

Krijimi i video-storieve të suksesit për punën e KCSF-së dhe grantistëve

NR. I REFERENCËS: 05/2023

PËRMBAJTJA

<u>FTESË PËR PROPOZIME</u>	3
<u>Përshkrimi i Fushëveprimit</u>	4
<u>Vlerësimi i Propozimeve - Kriteret e dhënies së kontratës</u>	6
<u>Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit</u>	7
<u>Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi</u>	7
<u>Shtojca 3: Formulari i propozimit teknik</u>	7
<u>Shtojca 4: Formulari i propozimit financiar</u>	7
<u>Shtojca 5: Udhëzime dhe informacione për Tenderuesit</u>	7
<u>Shtojca 6: Termat dhe kushtet e kontratës</u>	7

FTESË PËR PROPOZIME

Të nderuar,

- I. Jeni të ftuar të paraqisni një *propozim në e-mail adresën e dhënë në paragrafin 4* për aktivitetin e prokurimit të cekur më poshtë në përputhje me udhëzimet e bashkangjitura për tenderuesit.
- II. Propozimi juaj duhet të pranohet deri në ora **23:59 më 28 gusht 2023** dhe do të mbetet i hapur në rast se data e fundit e lartpërmendur për këtë aktivitet të prokurimit ndryshohet. Të gjitha dokumentet e paraqitura duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në këtë ftesë të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.
- III. Nga ju kërkohet të plotësoni dhe të ktheni “Shtojcën 3: Formulari i propozimit financiar” së bashku me të gjitha shtojcat e kërkuara tek dokumentet e tjera në përputhje me ftesën për tender siç janë renditur në ***Dokumentet që do të dorëzohen***.
- IV. **Titulli i kontratës:** Krijimi i video-storieve të suksesit për punën e KCSF-së dhe grantistëve
Numri i referencës: RFP 05/2023
Data e shpalljes: 10.8.2023
Data e mbylljes: 28.8.2023
Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj
Autoriteti kontraktues: FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
Email Adresa për dorëzimin e ofertave: tender@kcsfoundation.org
- V. Për pyetje dhe informacione shtesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe TeR ju lutem adresoni më poshtë:

E-mail: tender@kcsfoundation.org
Afati i fundit për pyetje: 23 gusht 2023, Ora 14:00

Vetëm tenderuesit e suksesshëm do të kontaktohen për të caktuar kohën e përshtatshme për informacione shtesë nëse është e nevojshme.

Ju lutemi sigurohuni për të dorëzuar propozimin në mënyrën dhe kohën e përshkruar në Udhëzimet dhe Informacionin për furnizuesit.

Me respekt,

KCSF

Përshkrimi i Fushëveprimit

1	Hyrja & Përmbledhja	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin European.
2	Qëllimi i shërbimit	KCSF synon të angazhoj kompani e cila do të do të prodhojë video storie të suksesit që do të plasohen në rrjete sociale dhe webfaqe lidhur me punën e KCSF-së dhe grantistëve që mbështeten përmes skemave të ndryshme brenda programeve të KCSF-së.
3	Përshkrimi i shkurtër i shërbimeve të kërkuara	KCSF pret që tenderuesi të prodhojë video storie të suksesit si produkte finale për publikim.
4	Qëllimi dhe fushëveprimi	KCSF pret që tenderuesi të zhvillojë dhe prodhojë në kohë dhe në mënyrë kreative: <ul style="list-style-type: none">• Konceptin dhe skenarin për prodhimin e 10-15 video storieve të suksesit 2-3.5 minutëshe.• Intervistojë personazhet e përzgjedhura për videon, të xhiroj pamjet, të realizoj postproduksionin.• Ofrojë të gjitha kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e videove të cilësisë së lartë.
5	Lista dhe përshkrimi i rezultateve të pritshme që duhet të dorëzohen	Ofruesi/kontraktori i shërbimit pritet të ofrojë video storiet e suksesit sipas kërkesave në Termet e Referencës: <ul style="list-style-type: none">- Propozimin për konceptin, regjinë, skenarin dhe krijimin e videove të përshtatshme për publikim në rrjete sociale dhe web- Afatin kohor të aktiviteteve të nevojshme të kërkuara për të përfunduar punën- Konsultimet me ekipin e KCSF-së, para dhe gjatë procesit
6	Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	Vendi i performimit të shërbimeve është: Kosova
7	Kohëzgjatja e pritshme e shërbimit	3 muaj
8	Data e synuar për fillimin e shërbimit	5 shtator 2023
9	Data e vlerësuar për përfundimin e shërbimit	30 nëntor 2023

10	Gjuha e propozimit	Shqipe									
11	Infosesion për aplikuesit	/									
13	Emrat dhe biografitë e individëve që do të përfshihen në kryerjen e shërbimeve	<input checked="" type="checkbox"/> Kërkohet <input type="checkbox"/> Nuk kërkohet									
14	Valuta e Propozimit	EUR									
15	Tatimi mbi vlerën e shtuar në propozimin e çmimit	<input type="checkbox"/> duhet të përfshijë TVSH-në dhe taksat e tjera indirekte të zbatueshme <input checked="" type="checkbox"/> duhet të jetë pa TVSH dhe tatimet e tjera indirekte të zbatueshme									
16	Siguria e tenderit	<input type="checkbox"/> Kërkohet <input checked="" type="checkbox"/> Nuk kërkohet									
17	Pozita financiare dhe pasqyrat financiare	<input type="checkbox"/> Kërkohet <input checked="" type="checkbox"/> Nuk kërkohet									
18	Periudha e vlefshmërisë së propozimeve (Nga dita e fundit e dorëzimit të ofertave)	<input checked="" type="checkbox"/> 60 ditë <input type="checkbox"/> 90 ditë <input type="checkbox"/> 120 ditë Në rrethana të jashtëzakonshme, KCSF mund t'i kërkojë Tenderuesve të zgjasin vlefshmërinë e Ofertës përtej asaj që është cekur fillimisht në këtë FPP. Ofertuesit pastaj do të konfirmojnë zgjatje e afatit me shkrim, pa ndonjë ndryshim në Propozim.									
19	Ofertimi i pjesshëm	<input checked="" type="checkbox"/> Nuk lejohet <input type="checkbox"/> Lejohet									
20	Kushtet e pagesës	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Këste</th> <th>Sipas rezultateve</th> <th>Afati kohor tentativ</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>30% Me nënshkrim të kontratës</td> <td>Shtator</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>70% Pas përmbylljes së të gjitha obligimeve</td> <td>Nëntor</td> </tr> </tbody> </table>	Këste	Sipas rezultateve	Afati kohor tentativ	1	30% Me nënshkrim të kontratës	Shtator	2	70% Pas përmbylljes së të gjitha obligimeve	Nëntor
Këste	Sipas rezultateve	Afati kohor tentativ									
1	30% Me nënshkrim të kontratës	Shtator									
2	70% Pas përmbylljes së të gjitha obligimeve	Nëntor									
21	Lloji i kontratës që do të nënshkruhet	Kontrat për shërbim									
24	Shtojcat e kësaj FPP-je	<input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 1: Termat e referencës / Përshkrimi i shërbimit <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 3: Formulari i propozimit financiar <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 4: Udhëzime për tenderuesit									
25	Afati i fundit për dorëzimin e pyetjeve për sqarim	2 ditë pune para afatit të fundit për dorëzimin e ofertës									
26	Dokumentet që do të dorëzohen:	<input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi (forma e KCSF-së) <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca 3: Propozimi financiar (forma e KCSF-së) <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca shtesë: Portfolio/CV e kompanisë <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca shtesë: Lista e pajisjeve profesionale <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca shtesë: CV e stafit të propozuar <input checked="" type="checkbox"/> Shtojca shtesë: Referencat									

Shtojca shtesë: Certifikata e regjistrimit dhe numrit fiskal dhe unik të biznesit nga organet përkatëse në vendin e origjinës që përcakton themelimin ose statusin ligjor, vendin e regjistrimit dhe vendin kryesor të operimit.

Vlerësimi i Propozimeve - Kriteret e dhënies së kontratës

Përderisa çmimi është faktor i rëndësishëm, KCSF do të vlerësojë propozimet në bazë të çmimit dhe kriterëve të mëposhtme:

KRITERI 1	Kapacitetet për përmbushjen e detyrave: i. Stafit i kualifikuar për realizimin e detyrave (CV e stafit) 20p; ii. Listë e pajisjeve profesionale për realizimin e videove 10p;	Koeficienti	30%
KRITERI 2	Përvoja relevante për përmbushjen e detyrave: i. Përvoja e kompanisë në zhvillimin e video storieve të suksesit apo videove promovuese, 20p; ii. Përvoja në realizimin e projekteve të madhësisë dhe fushëveprimtarisë së kërkuar, 10p; iii. Referencat, 10p;	Koeficienti	40%
KRITERI 3	Propozimi Financiar: i. Çmimi më i ulët (=Çmimi më i ulët/Çmimi i propozuar*25p), ii. Qartësia e çmimit dhe çmimi konkurrues 5p	Koeficienti	30%